



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREĆINE, PROJEKTOVANJE PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. Org. Unit: SP-02 Nr. i Prot. Prot. No: 1442-2/25
Në i Fajteve. Pe Shprehje No Pages: -05- Datime: 28.07.25
PRISHTINË / A No 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	28.06.2025
REFERENC-Ë:	25/1442/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Perlat Recycling" LLC, Harilaq, Fushë Kosovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/1442/106/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Perlat Recycling" LLC, Harilaq, Fushë Kosovë, për Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimin Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit dhe Magazinimit të Mbeturinave Metalike në Harilaq, Fushë Kosovë, në ngastrën kadastrale me Nr. P-72514003-00022-4 në ZK Harilaq, Fushë Kosovë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Perlat Recycling" LLC, Harilaq, Fushë Kosovë - pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimit Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit dhe Magazinimit të Mbeturinave Metalike në Harilaq, Fushë Kosovë, në ngastrën kadastrale me Nr. P-72514003-00022-4 në ZK Harilaq, Fushë Kosovë, nën kushtet si vijon, nën kushtet si vijon:

- Subjekti duhet të sigurojë që të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin e mbeturinave të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke parandaluar çdo ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin e njerëzve.
- Mbeturinat që prahen në objekt duhet të ndahen sipas kategorisë dhe natyrës së tyre, të ruhen në vende të përshtatshme, të mbuluara dhe të papërshtatshme nga uji dhe lëndët ndotëse, duke parandaluar rrjedhjen e substancave të rrezikshme në tokë apo në rrjetin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

- Vajrat e përdorura dhe materialet e tjera të ndjeshme duhet të ruhen në kontejnerë të mbyllur dhe në sipërfaqe të mbrojtura, me sistem për kapjen e rrjedhjeve dhe mbledhjen e ujërave të kontaminuara.
- Gjatë procesit të transportimit, duhet të përdoren mjete të mbyllura dhe të përshtatshme për llojin e mbeturinës, duke mbajtur dokumentacion të saktë për çdo lëvizje dhe për vendin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar të mbeturinave.
- Trajtimi fizik, përpunimi dhe riciklimi i materialeve duhet të realizohen me pajisje që nuk krijojnë ndotje të ajrit, ujit apo tokës, ndërsa impianti duhet të jetë i pajisur me sistem filtrimi, ventilimi dhe grumbullimi të pluhurit apo avujve që mund të çlirohen gjatë procesit të riciklimit.
- Ujërat e ndotura që mund të krijohen gjatë pastrimit të makinerive apo gjatë proceseve teknologjike duhet të mblidhen në rezervuarë të veçantë dhe të trajtohen përpara çdo shkarkimi eventual në rrjetin publik apo në mjedis, duke respektuar standardet e lejueshme për parametrat e ndotjes.
- Subjekti duhet të marrë masa për të kontrolluar nivelin e zhurmës dhe të parandalohet përhapja e saj përtej kufijve të pronës, në përputhje me standardet e përcaktuara në aktet nënligjore.
- Qendra duhet të ketë të hartuar një plan të menaxhimit të emergjencave, i cili përfshin procedurat për reagim ndaj zjarrit, rrjedhjeve kimike, ndotjeve aksidentale apo incidenteve të tjera që mund të kenë ndikim në mjedis, dhe duhet të jetë e pajisur me mjete të nevojshme për ndërhyrje dhe staf të trajnuar.
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorime të rregullta të parametrave mjedisorë relevantë, përfshirë cilësinë e ajrit, tokës, ujërave dhe nivelin e zhurmës, dhe të dorëzojë raporte periodike pranë Ministrisë përkatëse.
- Ndalohe ndryshimi i teknologjisë, rritja e kapacitetit apo shtimi i aktiviteteve pa pëlqim paraprak nga autoriteti kompetent.
- Subjekti është gjithashtu i obliguar të lejojë qasje për inspektim nga organet mbikëqyrëse në çdo kohë dhe të mbajë të gjitha evidencat dhe dokumentet që lidhen me aktivitetin, mbeturinat dhe ndikimin mjedisor për një periudhë kohore të përcaktuar me ligj.
- Të gjitha veprimet e ndërmarra në kuadër të këtij aktiviteti duhet të jenë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Ujërat, Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe aktet e tjera relevante, duke u bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së burimeve natyrore.

Aplikuesi gjatë realizimit të projektit përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (revokohet).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Perlat Recycling" LLC, Harilaq, Fushë Kosovë, për Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimit Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit dhe Magazinimit të Mbeturinave Metalike në Harilaq, Fushë Kosovë, në ngastrën kadastrale me Nr. P-72514003-00022-4 në ZK Harilaq, Fushë Kosovë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedor.

Ky Pëlqim Mjedor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejt.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/1442/1 - ZSP/ /25 datë: 28.06.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Komunës së Fushë Kosovës
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

Anex i Pëlqimit Mjedisor: Kodet e Mbeturinave sipas Udhezimit Administrativ Nr. 13/2013 për katalogun shtetror të Mbeturinave

Tabela e kodeve të mbeturinave të lejuara për qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, maganizimit, të mbeturinave metalike nga Kompania "PERLAT RECYCLING" L.L.C., Harilaç, komuna Fushë Kosovë.

Tabelave e kodeve te mbeturinave për të cilat është pajisur me Pëlqim Mjedisor kompania "PERLAT RECYCLING" L.L.C., Harilaç, komuna Fushë Kosovë				
02 01 10	16 01 06	16 06 03*	17 04 01	17 04 07
10 03 05	16 01 17	16 06 04	17 04 02	19 10 01
15 01 04	16 01 18	16 06 05	17 04 03	19 10 02
15 01 05	16 02 16	16 06 06*	17 04 04	19 12 02
15 01 06	16 06 01*	16 08 01	17 04 05	19 12 03
16 01 03	16 06 02*	16 08 03	17 04 06	20 01 40



2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.